

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	23.12.2024	Përsëndetje. Pranë Inspektoratit Qendror është administruar në formë elektronike kërkesa për informacion, drejtor ekzekutiv i organizatës jofitimprurëse Qendra “Centre for Legal Empowerment”, përmes së cilës kërkon informacion, si vijon: A janë kryer inspektime në fshatin Bërdicë (përfshirë dhe zonën e mbrojtur)? Nëse po, të vihen në dispozicion kopje të raporteve për inspektimet e kryera. A është konstatuar nëse ushtrohet veprimtari minerare me karrierë (gurore) në fshatin Bërdicë (në zonën e mbrojtur dhe jashtë saj)? A janë konstatuar shkelje të kuadrit ligjor në fuqi nga subjektet që ushtrojnë veprimtari	07.01.2025	Përsëndetje, Në vijim të informacionit të dërguar në lidhje me inspektimet në fshatin Bërdicë përfshirë dhe zonën e mbrojtur nga institucioni i IKMT-së informojmë si më poshtë: Duke u mbështetur në informacionet e marra nga Drejtoria e Mjedisit dhe Ujrave në Drejtorinë Qendrore, si dhe verifikimin e bërë nga Drejtoria Rajonale Shkodër, nuk rezulton që të jetë kryer inspektim në zonën e Bërdicës. Gjithashtu ju njoftojmë se në këtë zonë nuk rezulton të ketë veprimtari minerare me karrierë (gurore). Ju falenderojmë për mirëkuptimin	Kthim përgjigje (07.01.2025)	Nuk ka

		minerare me karrierë (gurore) në fshatin Bërdicë? Nëse po, çfarë masash janë marrë, si dhe të vendosen në dispozicion kopje të masave të marra. Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”,				
2	08.01.2025	Drejtuar: Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit Tiranë Për dijeni: Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit Përshëndetje, Duke u mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe në përputhje me nenet e këtij ligji, i cili rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, ju drejtojmë me këtë kërkesë për të marrë informacionin e mëposhtëm: 1. Sa herë është gjobitur nga institucioni juaj shtetasi,? 2. Cilat kanë qenë shkeljet përkatëse nga ana e duke	09.01.2025	Përshëndetje , Drejtuar: Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë Në adresën e-mailit të koordinаторit të të drejtës për informim, IKMT, është paraqitur për dijeni kërkesa nga, për informacion mbështetur në Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”. Bashkëlidhur po Ju përcjellim për kompetencë kërkesën sipas ligjit të sipërcituar paraqitur nga ...për verifikim dhe trajtim nga ana Juaj. Faleminderit për bashkëpunimin!	Per kompetence	Nuk ka

		vendosur në dispozicion kopjet e vendimeve? 3. A i ka shlyer ai detyrimet dhe nëse jo, sa është vlera e gjobave sot, duke llogaritur dhe kamatëvonesat? Bazuar në detyrimet ligjore për transparencë dhe në të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, presim që të na mundësoni informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj. Me respekt,				
--	--	--	--	--	--	--

Përgjigjeve

² *Data e regjistrimit të kërkesave*

³ *Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi*

⁴ *Data e kthimit të përgjigjes*

⁵ *Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi*

⁶ *Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar*

⁷ *Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik.*